

V E N D I M
Nr.217, datë 7.8.2001

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË ZONËS ZGJEDHORE NR.14

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, asistuar nga sekretarja Merita Dulaku, në mbledhjen e tij të datës 7.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gasper Kokaj	Zëvendëskryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

Objekt: Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.14.

Baza Ligjore: Neni 18, pika 4, të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

KONSTATOI SE:

Komisioni i zonës zgjedhor nr.14, me vendimin nr.17, datë 23.7.2001, ka shpallur deputet të drejtpërdrejtë në zonën zgjedhore nr.14, z.Ndre Legisi, përfaqësues i Partisë Socialiste Shqiptare. Nga shqyrtimi i tabelës së rezultateve të zonës zgjedhore nr.14 Model 39/1 u vërejt se diferenca ndërmjet kandidatit të parë dhe kandidatit të dytë, ishte 441 vota, ndërkohë që numri i fletëve votimi të pavlefshme është 503. Meqenëse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjendej përpara kërkesave të rinumërimit, të parashikuar nga neni 108 i Kodit Zgjedhor, vendosi të shpallë rezultatin e zgjedhjeve për këtë zonë zgjedhore, pasi të kryhej procesi i rinumërimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mirditë, me vendimin nr.101, datë 25.7.2001, ka vendosur të kthejë pa veprime kërkesën e paraqitur nga zëvendëskryetari i KZZ-së nr.14 dhe përfaqësuesit të kandidatit, z.Llesh Cupi për kryerjen e rinumërimit nga ana e kësaj Gjykate. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim nga z.Kolin Gjoka, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.14 në Gjykatën e Apelit të Tiranës. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.104, datë 2.8.2001, ka vendosur mospranimin e ankimit kundër vendimit nr.101, datë 25.7.2001, të Gjykatës së Shkallës së Parë Mirditë.

Gjithashtu, kandidati për deputet në këtë zonë zgjedhore z.Kolin Gjoka ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një kërkesë ankimore në të cilën kërkohej kryerja e procedurave të rinumërimit. Për këtë arsye, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.201, datë 31.7.2001, ka vendosur t'i kërkojë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, kryerjen e procedurave të rinumërimit. Gjykata e Rrethit Mirditë me shkresën nr.137/1, ka kthyer pa veprim vendimin nr.201, datë 31.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me arsyetimin se në bazë të nenit 36, paragrafi 3 i Kodi i Procedurës Civile, asnjë institucion nuk ka të drejtë të shqyrtojë mosmarrëveshjet të cilat janë duke u shqyrtuar nga gjykatat.

Në këto kushte, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se nga ana e kërkuesit janë konsumuar instrumentat ligjore të ankimit të parashikuara nga Kodi Zgjedhor. Duke qenë se vendimi i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për këtë zonë zgjedhore.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000

"Për kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

Të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.14, duke njohur si fitues kandidatin për deputet z.Ndre Legisi, përfaqësues i Partisë Socialiste Shqiptare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetar
Gasper Kokaj

Kryetari
Ilirjan Celibashi